ÇFARË NDODH PAS DIPLOMIMIT NGA SHKOLLA? REZULTATET NGA GJURMIMI I TË DIPLOMUARVE 2016-2025

Shkolla e mesme profesionale “Kristo Isak”

© 2026 Swisscontact

Rreth projektit "Aftësi për Punë" S4J

"Aftësi për Punë" S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Lista e tabelave

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit (2016-2025) 10
Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2025) 17
Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2016-2025) 18
Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2016-2025) 18
Tabela 5: Perceptimet për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2016-2025) 25
Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2016-2025) 26
Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2016-2025) 27
Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2016-2025) 27
Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2025) 30
Tabela 10: Arsyet kryesore të papunësisë (2016-2025) 32
Tabela 11: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkollë “shumë/jashtëzakonisht shumë” 34
Tabela 12: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2025) 35
Tabela 13: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2016-2025) 37

Lista e figurave

Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2025) 10
Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2025) 11
Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2025) 11
Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2025) 12
Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2016-2025) 12
Figura 6: Punësimi përkundrejt vetë-punësimit (2016-2025) 13
Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2025) 14
Figura 8: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2025) 14
Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2016-2025) 15
Figura 10: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2025) 16
Figura 11: Lidhja e punës me arsimin sipas gjinisë (2025) 16
Figura 12: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2025 19
Figura 13: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) (2016-2025) 19
Figura 14: Niveli i pagave sipas drejtimit (2025) 20
Figura 15: Niveli i pagave sipas gjinisë (2025) 21
Figura 16: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjesshme (2016-2025) 22
Figura 17: Madhësia e kompanisë (2016-2025) 22
Figura 18: Lloji i kontratës (2016-2025) 23
Figura 19: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2016-2025) 24
Figura 20: Periudha kohore në kërkim të një pune (2025) 25
Figura 21: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2025) 28
Figura 22: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2025) 28

Figura 23: Lloji i institucionit (2020-2025) 29
Figura 24: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2025) 30
Figura 25: Papunësia ndër vite (2016-2025) 31
Figura 26: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2025) 31
Figura 27: Metodat e kërkimit për punë (2020-2025) 33
Figura 28: Niveli i të diplomuarve të papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune 33
Figura 29: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2018-2025) 35
Figura 30: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi dhe shkollë sipas gjinisë 2025 36

Tabela e përmbajtjes

Lista e tabelave....3
Lista e figurave....3
Gjetjet kryesore....6
Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?....8
Të diplomuarit 2016-2025....10
Analiza e rezultateve....12
Statusi i punësimit....12
Lidhja e punës me fushën e arsimit....15
Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës....17
Niveli i pagave....19
Kushtet e punës....21
Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqësia në vendin e punës....24
Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë....25
Mënyrat e gjetjes së punës së parë....26
Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme....28
Të diplomuarit pa punë....31
Propozimet për përmirësim në shkollë....34
Planet për të ardhmen....37

Gjetjet kryesore

Ky raport paraqet rezultatet kryesore nga gjurmimi i dhjetë brezave të të diplomuarve të shkollës "Kristo Isak" duke filluar me brezin e nxënësve të diplomuar në vitin 2016.

- Në vitin 2025, 51% e të diplomuarve të gjurmuar ishin të punësuar/vetëpunësuar një vit pas diplomimit. Viti 2025 shënon shkallën më të lartë të punësimit ndër vite me një rënie prej 3 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (54%). Për më tepër, viti 2025.
- Viti 2025, shënon një shkallë lartë të papunësisë me 27% me një ulje me vetëm 1 pikë përqindje nga
- mesatarja e viteve 2016-2024 (28%). Ndërkohë, 19% e të diplomuarve janë student/kursant me një rritje prej 5 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (13%).
- Për vitin 2025, 61% (N=11) e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm ishin të punësuar/vetëpunësuar dhe 5 i diplomuar ose 28% ishte i/e papunë një vit pas diplomimit dhe 2 të diplomuar ishin student ose kursant. Ndërkohë, 42% (N=8) e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore ishin të punësuar, 26% (N=5) ishin të papunë dhe 26% (N=5)ishin student/kursantë një vit pas diplomimit.
- 59% e të diplomuarve në vitin 2025 pohuan se puna që bëjnë lidhet me fushën e tyre të arsimit. Në të dhjetë brezat e gjurmuar 71% e të diplomuarve kanë pohuar lidhjen mes punës dhe fushës së arsimit. vërehet se vetë 14% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore pohojnë se puna që bëjnë lidhet me fushën e tyre të arsimit. Ndërkohë, 90% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm bëjnë një punë që lidhet me fushën e tyre të arsimit.
- 79% e të gjurmuarve pohojnë se i përdorin njohuritë dhe kompetencat e fituara në shkollë "shumë" dhe "jashtëzakonisht shumë", duke shënuar një rritje me 5 pikë përqindje nga viti pararendës.
- Për vitin 2025niveli , shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 53% deri në 50,000 lekë, 20% 50,001-60,000 lekë, 7% në fashën 60,001-80,000 lekë, 7% në fashën 80,001-95,000 lekë, dhe 13% paguhen më shumë se 120,000 lekë. E shprehur në vlerë absolute vetëm 2 nga 22 të diplomuarit e punësuar merr një pagë më shumë se 120,000 lekë një vit pas diplomimit.
- Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve vëmë re se 2 (11%) i diplomuar në Hoteleri - Turizëm dhe 17% e të diplomuarve në drejtimin Shërbime Sociale dhe Shëndetësore marrin një pagë më shumë se 120,001 lekë. Ndërkohë, drejtimin Shërbime Sociale dhe Shëndetësore 67% e të gjurmuarve marrin një pagë deri në 50,000 lekë. Në drejtimin e Hoteleri – Turizëm vetëm 44% e të diplomuarve merr një pagë deri në 50,000 lek. Nga ana tjetër 11% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm marrin një pagë 80,001 – 95,000 lekë. Në drejtimin Shërbime Sociale dhe Shëndetësore 17% e të diplomuarve merr një pagë 50,000 – 60,000 lekë.
- 47% e të diplomuarve në vitin 2025 u përgjigjën se kanë arritur të gjejnë punën para diplomimit (shiko figurën 20). 20% 1 muaj pas diplomimit dhe nga 13% 1- 3 muaj pas

diplomimit, 7% nga 3-6 muaj pas diplomimit, 7% nga 6-9 muaj pas diplomimit dhe 7% nga 9-12 muaj pas diplomimit.


- Për të dhjetë brezat e gjurmuar lidhjet personale të pjesëtarëve të familjes dhe të njohurit e tyre janë forma më e zakonshme nëpërmjet së cilës të diplomuarit kanë gjetur punë për herë të parë. Mesatarisht 51% e të diplomuarve gjatë viteve 2016-2024 kanë gjetur punë nëpërmjet lidhjeve personale. Për të diplomuarit e vitit 2025 kjo përqindje është 33%, duke shënuar një ulje me 22 pikë përqindje për këtë kategori. Për më tepër 27% janë shprehur se e kanë gjetur punën e parë nga kategoria "tjetër", 20% e kanë gjetur përmes praktikës profesionale në biznes, dhe 20% e kanë gjetur nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale, gazeta.
- 73% e të diplomuarve në vitin 2024, u shprehën se ndjehen "të sigurt ose shumë të sigurt" (shiko tabelën 5). Këtu vihet re një përmirësim me 18 pikë përqindje në raport me vitin 2024, ku 55% e të diplomuar janë shprehur se ndjeheshin "të sigurt ose shumë të sigurt" në punën e tyre. Gjithashtu, 20% e të diplomuarve në vitin 2025 ndjehen "të pasigurt ose shumë të pasigurt" në punën aktuale me një rritje prej 11 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (9%). Ndërkohë, 86% e të diplomuarve në vitin 2025 shprehen se ndjehen "të kënaqur ose shumë të kënaqur" dhe 7% shprehen "të pakënaqur ose shumë të pakënaqur". Në këtë aspekt vërehet një rënie e pakënaqësisë me 4 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016 - 2024 (11%).
- Sipas rezultateve të të gjurmuarve në vitin 2025, theksi është vënë tek përmirësimi i praktikës në biznes me 87%, nevoja për përmirësim të këshillimit të karrierës 81%, aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve (79%), bashkëpunimi me bizneset (78%) si dhe tek përmirësimi i praktikës në shkollë (77%).
- Brenda dy viteve të ardhshme, 51% e të diplomuarve në vitin 2025 kanë pohuar se kanë dëshirë të kenë filluar biznesin e tyre. Aspiratat për sipërmarrje në këtë vit kanë shënuar rritje me 12 pikë përqindje në raport me mesataren e viteve 2016-2024 e cila ka qenë 39%. Parë në një këndvështrim krahasues, në planet e tyre për të ardhmen, mesatarisht 23% e të diplomuarve shprehen se dëshirojnë të jenë të punësuar dhe 23% të gjejnë një punë të lidhur ngushtë me fushën e tyre të studimit (mesatarja dhjetë brezave). Ndërkohë, 19% (mesatarja e dhjetë brezave) shprehen se do ndjekin studime të mëtejshme dhe 16% se duan të emigrojnë jashtë vendit. Ndërkohë, dëshira për migrim të brendshëm është 0% për të nëntin vit radhazi.

Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e një institucioni arsimor realizohet përmes 'studimeve gjurmuese' që ndjekin ose 'gjurmojnë' **të diplomuarit** pasi ata diplomohen. Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të arsimit profesional në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.

Të dhënat dhe rezultatet e gjurmimit përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi **relevancën e ofertës** për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.

Avantazhet e një sistemi gjurmimi në nivel ofruesi



Në këtë kuadër, Kristo Isak, me mbështetjen e projektit 'Aftësi për Punë' (S4J) ka ngritur një **sistem gjurmimi** në nivel ofruesi për të diplomuarit e saj. Ky sistem gjurmimi përmbush dy qëllime të rëndësishme:

a. Monitorimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e shkollës.
b. Vlerësimin e lidhjes (përputhshmërisë horizontale) midis arsimit dhe punës.

Zbatimi i procesit të gjurmimit në praktikë zhvillohet në **tre faza kryesore** siç është e ilustruar në diagramën më poshtë.



Në fazën e para-gjurmimit, që kryhet në majin e çdo viti shkollor, realizohet para-gjurmimi i maturantëve që pritet të diplomohen në qershor. Para-gjurmimi kryhet me anë të një pyetësori të strukturuar online. Anketa mbledh të dhënat e kontaktit të maturantëve, karakteristikat e tyre socio-demografike, si dhe planet dhe pritshmëritë e tyre të karrierës për të mundësuar kështu gjurmimin e tyre një vit më pas.

Në fazën e gjurmimit, që kryhet në qershorin e çdo viti shkollor realizohet gjurmimi i të diplomuarve nga shkolla një vit më parë. Të diplomuarit raportojnë mbi përvojën e kalimit në tregun e punës dhe bëjnë vlerësimin në retrospektivë të shkollës së tyre përmes një pyetësori të standardizuar online duke përdorur platformën Kobo Toolbox.

Në fazën përmbyllëse të procesit analizohen rezultatet e gjurmimit dhe prezantohen rezultatet. Pjesa më e rëndësishme e procesit është leximi i këtyre gjetjeve dhe reflektimi i brendshëm i institucionit mbi të dhënat dhe ndërmarrja e hapave konkrete si rrjedhojë.

Procesi i gjurmimit koordinohet nga **koordinatori i gjurmimit** me mbështetjen e Njësisë së Zhvillimit dhe mësuesve kujdestarë, nën kujdesin e projektit 'Aftësi për Punë'.

Ky raport përmbledhës pasqyron rezultatet kryesore nga gjurmimi i **dhjetë brezave me të diplomuar** të shkollës "Kristo Isak".

Të diplomuarit 2016-2025


Në vitin shkollor 2024-2025, në shkollën “Kristo Isak” u diplomuan 41 nxënës (shiko tabelën 1), 1 nxënës më shumë se gjatë vitit shkollor 2023-2024. Nga të diplomuarit e vitit 2024-2025 u gjurmuan 37 nxënës ose 90% e të diplomuarve.

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit (2016-2025)

Brezi	Të diplomuar	Të anketuar	%
2015-2016	49	40	81%
2016-2017	8	8	100%
2017-2018	72	70	97%
2018-2019	23	22	96%
2019-2020	40	39	98%
2020-2021	38	38	100%
2021-2022	35	35	100%
2022-2023	36	30	83%
2023-2024	40	36	90%
2024-2025	**41**	**37**	**90%**

Pjesa më e madhe e të diplomuarve të gjurmuar i përkasin gjinisë mashkullore (shiko figurën 1). Përkatësisht 51% (N=19) e të gjurmuarve janë djem dhe 49% (N=18) janë vajza.


Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=37

Ndërsa të shpërndarë sipas drejtimeve (shiko figurën 2), përqindjen më të lartë të të gjurmuarve e kanë të diplomuarit e drejtimit Shërbime Social me 51% (N=19). Ndërkohë janë gjurmuar edhe 49% (N=18) e të diplomuarve në Hoteleri Turizëm.


Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=37

Të pyetur lidhur me vendbanimin, 92% (N=34) e të diplomuarve janë përgjigjur se jetojnë në Shqipëri dhe 8% (N=3) jetojnë jashtë vendit. Për vitin 2025, kemi një rritje me 10 pikë përqindje të numrit të të diplomuarve të cilët jetojnë në Shqipëri, krahasuar me një vit më parë. Mesatarisht, përgjatë viteve 2020-2024, 82% e të diplomuarve të gjurmuar jetojnë në Shqipëri dhe 18% jetojnë jashtë Shqipërisë.

Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2020** (N=39); **2021** (N=38); **2022** (N=35); **2023** (N=36) ; **2024** (N=36), **2025** (N=37).

Analiza e rezultateve

Statusi i punësimit

Sipas rezultateve të brezit të fundit të të gjurmuarve (2023-2025), nga një total prej 37 të anketuarish 35% ishin të punësuar një vit pas diplomimit (shiko figurë 4), 11% ishin të vetëpunësuar, 19% ishin student/kursant dhe 5% ishin të punësuar por edhe studionin në të njëjtën kohë. Ndërkohë, të papunë ishin 27% e të anketuarve. E shprehur në numër absolut 10 nga 37 të diplomuarit e gjurmuar ishin të papunë.


Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=37

Referuar figurës 5, në vitin 2025 shkalla e punësimit të të diplomuarve është 51% me një rënie prej 3 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (54%). Për më tepër, viti 2025 shënon një shkallë lartë të papunësisë me 27% me një ulje me vetëm 1 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (28%). Ndërkohë, 19% e të diplomuarve janë student/kursant me një rritje prej 5 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (13%).


Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=40); **2017** (N=8); **2018** (N=70); **2019** (N=22); **2020** (N=39); **2021** (N=38); **2022**: (N=35); **2023** (N=36); **2024** (N=36), **2025** (N=37).

Të anketuarit që janë shprehur se janë në marrëdhënie pune janë pyetur më tej nëse janë të punësuar apo të vetëpunësuar. Sikurse vihet re nga figura 6, shumica e të diplomuarve ndër vite janë shprehur se janë të punësuar dhe një numër i vogël prej tyre janë të vetëpunësuar. Kështu, mesatarisht (2016-2025), 43% e të diplomuar punësohen dhe vetëm 7% vetëpunësohen. Niveli më i lartë i vetëpunësimit është shënuar në vitin 2017 me 13% dhe më i ulëti në vitin 2016, 2022 dhe 2023 me 3% secili. Ndërkohë, niveli më i lartë i punësimit është shënuar në vitin 2023 më 63%. Në vitin 2025 35% e të anketuarve janë të punësuar ndërsa 11% janë të vetëpunësuar.

Figura 6: Punësimi përkundrejt vetë-punësimit (2016-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e

barabartë me 100%. %. **Baza: 2016** (N=40); **2017** (N=8); **2018** (N=70); **2019** (N=22); **2020** (N=39); **2021** (N=38); **2022**: (N=35); **2023** (N=36); **2024** (N=36), **2025** (N=37).

Në figurën 7, jepet statusi i punësimit sipas drejtimeve të ofruara nga shkolla për vitin 2025. Sikurse vihet re, 61% (N=11) e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm ishin të punësuar/vetëpunësuar dhe 5 i diplomuar ose 28% ishte i/e papunë një vit pas diplomimit dhe 2 të diplomuar ishin student ose kursant. Ndërkohë, 42% (N=8) e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore ishin të punësuar, 26% (N=5) ishin të papunë dhe 26% (N=5)ishin student/kursantë një vit pas diplomimit.


Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: HT** (N=18); **SHSSH** (N=19)

Të ndara sipas gjinisë (shih figurën 8), të dhënat tregojnë se 63% (N=12) e të diplomuarve meshkuj janë të punësuar dhe 21% (N=4) janë të papunë dhe 16% (N=3) student ose kursant. Ndërkohë, vetëm 39% (N=7) e të diplomuarave të gjinisë femërore janë të punësuara, 33% (N=6) janë të papuna dhe 22% (N=4) janë studente ose kursante.

Figura 8: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: M** (N=19); **F** (N=18).

Lidhja e punës me fushën e arsimit

Të pyetur nëse puna aktuale lidhet me fushën e tyre të arsimit, 59% e të diplomuarve në vitin 2025 pohuan se puna që bëjnë lidhet me fushën e tyre të arsimit. Në të dhjetëtë brezat e gjurmuar 71% e të diplomuarve kanë pohuar lidhjen mes punës dhe fushës së arsimit.


Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=9); **2017** (N=5); **2018** (N=31); **2019** (N=6); **2020** (N=23); **2021** (N=24); **2022** (N=20); **2023** (N=21); **2024** (N=27)); **2025** (N=15)

Nëse analizojmë lidhjen e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit për vitin 2025 (shiko figurën 10), vërehet se vetë 14% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore pohojnë se puna që bëjnë lidhet me fushën e tyre të arsimit. Ndërkohë, 90% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm bëjnë një punë që lidhet me fushën e tyre të arsimit.


Figura 10: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: HT** (N=10); **SHSSH** (N=10).

Të ndara sipas gjinisë, të dhënat tregojnë se 80% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 40% e të diplomuarave të gjinisë femërore punojnë në profesion.

Figura 11: Lidhja e punës me arsimin sipas gjinisë (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** (N=15)

Të pyetur lidhur me arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (shiko tabelën 2), vërehet se të diplomuarit ndër vite japin si një ndër arsyet kryesore pamundësinë e gjetjes së një vendi pune që lidhet me studimet e tyre. Kështu, mesatarisht 60% e të diplomuarve në vitet 2018-2024 që kanë pohuar se puna që bëjnë nuk lidhet me arsimin e tyre, kanë dhënë si arsye kryesore pamundësinë e gjetjes së një pune që lidhet me studimet. Ndërkohë, gjatë vitit 2025 kemi të njëjtën përqindje për këtë kategori pra 60% (ose 3 nga 5 të diplomuar).Ndërkohë, 1 nga 5 të diplomuar ose 20% kanë dhënë si arsye faktin që puna aktuale ofron pagë/kushte më të mira. Mesatarisht, 25% e të diplomuarve 2018-2024 kanë pohuar se puna që kanë ofron pagë/kushte më të mira, me një rënie me prej 5 pikë përqindje për vitin 2025. Gjithashtu 1 nga 5 të diplomuar ose 20% kanë dhënë si arsye faktin që nuk duan të punojnë në një punë që lidhet me studimet e tyre.

Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2025)

	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Nuk gjeta një vend pune që lidhet me studimet e mia	90%	100%	50%	75%	50%	25%	33%	**60%**
Nuk dua të punoj në një punë që lidhet me studimet e mia	0%	0%	0%	13%	33%	0%	0%	**20%**
Nuk ka oferta pune në fushën time në rajon	0%	0%	0%	0%	17%	0%	0%	**0%**
Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira	10%	0%	50%	0%	0%	50%	67%	**20%**
Tjetër	0%	0%	0%	13%	0%	25%	0%	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018** (N=10); **2019** (N=1); **2020** (N=4); **2021** (N=8); **2022** (N=6); **2023** (N=4) **2024** (N=6), **2025** (N=5).

Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës

Të pyetur nëse njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë studimit i përdorin në vendin e punës (shiko tabelën 3), rezultatet e gjurmimit të të diplomuarve në vitin 2025 tregojnë se njohuritë përdoren "shumë/jashtëzakonisht shumë" nga 79% e të gjurmuarve. Vihet re një rritje me 18 pikë përqindje në krahasim me vitin e mëparshëm (61%). Niveli më i lartë ka qenë ai i vitit 2017 ku 100% e të diplomuarve kanë pohuar se i përdorin njohuritë dhe kompetencat e fituara në shkollë në vendin e punës në shkallën "shumë/jashtëzakonisht shumë".

Ndërkohë, 16% e të diplomuarve në vitin 2025 janë përgjigjur se i përdorin "aspak" njohuritë e fituara gjatë studimeve. Mesatarja e viteve 2016-2024 ka qenë 10% duke pasur një rritje me 6 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2016-2024. Ndërsa kategoria e atyre që janë përgjigjur se i përdorin "disi" njohuritë për vitin 2025 është 16%, dhe kemi një ndryshim me 3 pikë përqindje në raport me mesataren e viteve 2016-2024 e cila ka qenë 19%.

Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2016-2025)

	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
2016	22%	33%	11%	22%	11%
2017	0%	0%	0%	40%	60%
2018	6%	6%	68%	19%	0%
2019	10%	10%	20%	20%	40%
2020	17%	26%	26%	13%	17%
2021	4%	4%	8%	50%	33%
2022	5%	0%	20%	35%	40%
2023	4%	14%	9%	32%	41%
2024	19%	0%	7%	33%	41%
2025	**16%**	**0%**	**16%**	**32%**	**37%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=9); **2017** (N=5); **2018** (N=31); **2019** (N=32); **2020** (N=10); **2021** (N=23); **2022** (N=24); **2023** (N=22); **2024** (N=27), **2025** (N=19).

Të pyetur për lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve të kryera (shiko tabelën 4), 58% e të diplomuarve në 2025 e vlerësojnë lidhjen e pozicionit të punës me studimet e kryera me "shumë/jashtëzakonisht shumë". Këtu, vihet re një rritje me 3 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2016-2024, ku 55% e të diplomuarve të gjurmuar e vlerësonin lidhjen mes pozicionit të punës me "shumë/jashtëzakonisht shumë". Nga ana tjetër, 5% e vlerësojnë me "pak" dhe 15% e të diplomuarve e vlerëson "aspak" lidhjen mes punës aktuale dhe studimeve.

Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2016-2025)


	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
2016	22%	22%	22%	11%	22%
2017	0%	0%	40%	20%	40%
2018	19%	3%	52%	13%	13%
2019	20%	10%	40%	30%	0%
2020	22%	22%	22%	4%	30%
2021	13%	0%	8%	46%	33%
2022	0%	15%	20%	25%	40%
2023	0%	11%	16%	37%	26%
2024	15%	0%	15%	22%	48%
2025	**26%**	**5%**	**11%**	**26%**	**32%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=9); **2017 (**N=5); **2018 (**N=31) **2019** (N=10); **2020** (N=23), **2021** (N=24); **2022** (N=20); **2023** (N=19) **2024** (N=27), **2025** (N=19)

Niveli i pagave

Në 2026. për shkak të ndryshimit të pagesës minimale (nga 40,000 lekë në 50,000 lekë) nga 1 janar 2026, janë rishikuar kategoritë e pagave ne pyetësor. Për sa i përket nivelit të pagave për të diplomuarit e punësuar, një vit pas diplomimit, për vitin 2025 (shiko figurën 12), shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 53% deri në 50,000 lekë, 20% 50,001-60,000 lekë, 7% në fashën 60,001-80,000 lekë, 7% në fashën 80,001-95,000 lekë, dhe 13% paguhen më shumë se 120,000 lekë. E shprehur në vlerë absolute vetëm 2 nga 22 të diplomuarit e punësuar merr një pagë më shumë se 120,000 lekë një vit pas diplomimit.


Figura 12: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2025



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=22

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara për nivelin e shpërndarjes së pagave jepet në figurën 13. Në vitin 2025 kemi një ndryshim të strukturës së pagave krahasuar me vitet 2016-2024. Kështu, 47% të diplomuarve në këtë vit marrin një pagë nga 35,000- 50,000 lekë duke shënuar një rritje prej 25 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (19%). 21% e të diplomuarve në këtë vit marrin një pagë 50,001 – 65,000 lekë, duke shënuar një rritje prej 5 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (16%). Ndërkohë, gjithashtu vërehet një rritje e nxënësve të cilët marrin një pagë 65,001-80,000 lekë. Në vitin 2025 11% e te diplomuarve e marrin pagën e mësipërme me një rritje prej 2 pikë përqindje nga viti 2024 gjatë të cilit 9% e të diplomuarve merrnin një pagë 65,001-80,000 lekë. Për më tepër, vërehet një rritje prej 8 pikë përqindje e nxënësve të cilët marrin më shumë se 80,001 lekë (13% mesatarja e viteve në 2016-2024) duke shënuar vitin me përqindjen më të lartë të diplomuarve (21%) që marrin një pagë më shume se 80,001.


Figura 13: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=9); **2017 (**N=5); **2018 (**N=31); **2019** (N=6); **2020** (N=23), **2021** (N=24); **2022** (N=20); **2023** (N=18), **2024** (N=27), **2025** (N=22).

Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve (shiko figurën 14), vëmë re se 2 (11%) i diplomuar në Hoteleri - Turizëm dhe 17% e të diplomuarve në drejtimin Shërbime Sociale dhe Shëndetësore marrin një pagë më shumë se 120,001 lekë. Ndërkohë, drejtimin Shërbime Sociale dhe Shëndetësore 67% e të gjurmuarve marrin një pagë deri në 50,000 lekë. Në drejtimin e Hoteleri – Turizëm vetëm 44% e të diplomuarve merr një pagë deri në 50,000 lek. Nga ana tjetër 11% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm marrin një pagë 80,001 – 95,000 lekë. Në drejtimin Shërbime Sociale dhe Shëndetësore 17% e të diplomuarve merr një pagë 50,000 – 60,000 lekë.


Figura 14: Niveli i pagave sipas drejtimit (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N_{HT}=9, N_{SHSSH}=6

Të disagreguara sipas gjinisë niveli i pagave jepet në figurën15. 60% e të diplomuarave të gjinisë femërore marrin një pagë më të ulët se paga minimale, ndërkohë 50% prej të diplomuarve të gjinisë mashkullore e merr këtë pagë. Nga ana tjetër, 20% e të diplomuarave të gjinisë femërore dhe 20% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore marrin një pagë mes 50,001 – 60,000 lekë. 10% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore marrin një pagë 60,001 – 80,000 lekë dhe po 10% marrin një pagë 80,000- 95,000 lekë. 10% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 20% e të diplomuarve të gjinisë femërore marrin një pagë mbi120,000 lekë.

Figura 15: Niveli i pagave sipas gjinisë (2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: $N_{=22}$

Kushtet e punës

Të pyetur lidhur me karakteristikat kryesore të punës (me kohë të plotë apo të pjesshme), për të dhjetë brezat e gjurmuar vërehet që mbizotëron punësim me kohë të plotë (mesatarja e të nëntë brezave 88%) dhe për vitin 2025 80% e tyre punojnë me kohë të plotë. Ndërkohë, mesatarisht (2016-2024), 8% e të diplomuarve kanë punuar në punë me kohë të plotë sezonale. Ndërkohë, në vitin 2025, 20% e të diplomuarve punojnë në punë me kohë të plotë sezonale, duke shënuar një rritje me 11 pikë përqindje nga mesatarja 9% e viteve 2016- 2024. Vërehet se të punësuar me kohë të pjesshme nuk ka gjatë vitit 2025 krahasuar me mesatarisht 4% e të diplomuarve 2016-2024 të cilët kanë punuar me kohë të pjesshme. E shprehur ne numër absolut nga 150 të diplomuar përgjatë viteve 2016-2025 vetëm 9 kanë pohuar se punojnë me kohë të pjesshme.

Figura 16: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjesshme (2016-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=8); **2017 (**N=4); **2018 (**N=28); **2019** (N=4); **2020** (N=20); **2021** (N=21); **2022** (N=19); **2023** (N=21) **2024** (N=25), **2025** (N=15).

Përsa i përket shpërndarjes së të diplomuarve sipas tipologjisë së kompanisë (shiko figurën 17), në brezin e fundit të të gjurmuarve vërehet se 20% e të diplomuarve punojnë në kompani me 1-4 punonjës, 47% në kompani me 5-9 punonjës, dhe 33% në kompani me 10-49 punonjës dhe nuk ka të diplomuar që punojnë në kompani me më shumë se 50 punonjës.

Ndërkohë, në një vështrim krahasues me vitet e mëparshme, mesatarisht 44% e të diplomuarve kanë punuar në kompani me 1-4 (20% në 2025), 31% në kompani me 5-9 punonjës (47% në 2025) dhe 16% në kompani me 10-49 punonjës (33% në 2025) dhe 9% në kompani me mbi 50 punonjës (0% në 2025).

Figura 17: Madhësia e kompanisë (2016-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=6); **2017 (**N=4); **2018 (**N=28); **2019** (N=4); **2020** (N=20); **2021** (N=21); **2022** (N=19); **2023** (N=21), **2024** (N=25), **2025** (N=15)

Në vitin 2025, 60% e të diplomuarve kanë një kontratë pune me punëdhënësin e tyre (shiko figurën 18). Nga ku 47% kanë një kontratë pune me afat të caktuar dhe 13% me afat të pacaktuar. Ndërkohë, i lartë është numri i atyre që nuk kanë një kontratë (40%). Në këtë kategori vërehet një rritje prej 3 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2016-2024 (37%).

Sikurse vihet re edhe nga figura 18, lloji i kontratës që mbizotëron këtë vit është ajo me afat të caktuar. Mesatarja e të dhjetë të brezave të gjurmuar është 30%. Ndërkohë, mesatarja e atyre me kontratë me afat të pacaktuar është 31%.

Figura 18: Lloji i kontratës (2016-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=8); **2017 (**N=4); **2018 (**N=28); **2019** (N=4); **2020** (N=20); **2021** (N=21); **2022** (N=19); **2023** (N=21), **2024** (N=25), **2025** (N=_15).

Sipas rezultateve të gjurmimit të të dhjetë brezave, mesatarisht 75% e të diplomuarve të punësuar deklarojnë se iu paguhen kontributet e detyrueshme nga ana e punëdhënësit (shiko figurën 19). Në vitin 2025 (67%) kemi një rënie me 9 pikë përqindje referuar vitit 2024 (76%).

Ndërkohë, gjatë vitit 2025 vihet re një rënie e numrit të të diplomuarve të cilët pohojnë se nuk u paguhen kontributet. Në vitin 2025, 20% e të të diplomuarve të cilët pohojnë se nuk ju paguhen kontributet nga punëdhënësi, duke shënuar një rritje me 6 pikë përqindje nga mesatarja 2016-2023 (14%). Nga ana tjetër, është rritur në 13% numri i të diplomuarve të cilët nuk kanë informacion nëse u paguhen apo jo kontributet në nga 10% që ka qenë mesatarja e viteve 2016- 2023.

Figura 19: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=8); **2017 (**N=4); **2018 (**N=28); **2019** (N=4); **2020** (N=20); **2021** (N=21); **2022** (N=19); **2023** (N=21); **2024** (N=25), **2025** (N=15).

Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqësia në vendin e punës

Të pyetur se sa të sigurt dhe të stabilizuar ndjeheshin në vendin e tyre të punës, 73% e të diplomuarve në vitin 2024, u shprehën se ndjehen "të sigurt ose shumë të sigurt" (shiko tabelën 5). Këtu vihet re një përmirësim me 18 pikë përqindje në raport me vitin 2024, ku 55% e të diplomuar janë shprehur se ndjeheshin "të sigurt ose shumë të sigurt" në punën e tyre.

Gjithashtu, për vitin 2025 është rritur edhe numri i të diplomuarve të cilët ndjehen "të pasigurt ose shumë të pasigurt" në punën aktuale. Kështu, 20% e të diplomuarve në vitin 2025 ndjehen "të pasigurt ose shumë të pasigurt" në punën aktuale me një rritje prej 11 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016- 2024 (9%).

Ndërkohë, të pyetur lidhur me kënaqësinë në vendin e punës, 86% e të diplomuarve në vitin 2025 shprehen se ndjehen “të kënaqur ose shumë të kënaqur” dhe 7% shprehen “të pakënaqur ose shumë të pakënaqur”. Në këtë aspekt vërehet një rënie e pakënaqësisë me 4 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016 - 2024 (11%).

Tabela 5: Perceptimet për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2016-2025)


	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Shumë i/e pasigurt	13%	0%	14%	25%	5%	10%	0%	14%	0%	**20%**
I/e pasigurt	0%	25%	36%	0%	5%	19%	0%	10%	4%	**0%**
Neutral	0%	25%	7%	50%	45%	33%	32%	33%	24%	**7%**
I/e sigurt	75%	25%	43%	25%	30%	29%	47%	33%	40%	**53%**
Shumë i/e sigurt	13%	25%	0%	0%	15%	10%	21%	10%	32%	**20%**
Shumë i/e pakënaqur	0%	0%	7%	25%	0%	0%	5%	10%	4%	**7%**
I/e pakënaqur	0%	0%	11%	0%	10%	14%	0%	10%	0%	**0%**
Neutral	0%	50%	11%	50%	40%	5%	32%	14%	12%	**7%**
I/e kënaqur	88%	0%	71%	0%	35%	76%	53%	52%	60%	**53%**
Shumë i/e kënaqur	13%	50%	0%	25%	15%	5%	11%	14%	24%	**33%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=8); **2017 (**N=4); **2018 (**N=28); **2019** (N=4); **2020** (N=20); **2021** (N=21); **2022** (N=19); **2023** (N=21), **2024** (N=25), **2025** (N=15).

Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për kohën që u duhet të presin derisa të fillojnë punën e tyre të parë, 47% e të diplomuarve në vitin 2025 u përgjigjën se kanë arritur të gjejnë punën para diplomimit (shiko figurën 20). 20% 1 muaj pas diplomimit dhe nga 13% 1- 3 muaj pas diplomimit, 7% nga 3-6 muaj pas diplomimit, 7% nga 6-9 muaj pas diplomimit dhe 7% nga 9-12 muaj pas diplomimit.

Figura 20: Periudha kohore në kërkim të një pune (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=15

Mesatarisht, 47% e të diplomuarve përgjatë viteve 2016-2024 (shiko tabelën 6), kanë gjetur një punë para diplomimit, me të njëjtën përqindje me vitin 2025. Ndërkohë, mesatarisht 6% e të diplomuarve përgjatë viteve 2016-2024 e kanë gjetur punën 1 muaj pas diplomimit me një ndryshim prej 14 pikë përqindje në vitin 2025 (20%). Vlen të theksohet se përqindja e atyre që gjejnë punë më shumë se 1 vit pas diplomimit vijon të mbetet 0 (zero) për të nëntin vit radhazi.

Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2016-2025)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Para diplomimit	17%	25%	17%	25%	50%	52%	79%	62%	84%	**47%**
1 muaj pas diplomimit	33%	0%	3%	13%	0%	12%	4%	5%	8%	**20%**
1 - 3 muaj pas diplomimit	0%	25%	14%	25%	18%	8%	0%	10%	8%	**13%**
3 - 6 muaj pas diplomimit	8%	25%	31%	0%	14%	20%	8%	10%	0%	**7%**
6 - 9 muaj pas diplomimit	17%	0%	34%	13%	14%	4%	8%	5%	0%	**7%**
9 - 12 muaj pas diplomimit	0%	25%	0%	25%	5%	4%	0%	10%	0%	**7%**
Më shumë se 1 vit pas diplomimit	25%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=5); **2017 (**N=11); **2018 (**N=30); **2019** (N=26); **2020** (N=36); **2021** (N=51); **2022** (N=43); **2023** (N=21),); **2024** (N=25), **2025** (N=15).

Mënyrat e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për mënyrën e gjetjes së punës së parë, vërehet se 33% e të diplomuarve në vitin 2025 pohojnë se e kanë gjetur punën e parë nga njohjet, lidhjet familjare dhe miqtë, me një ulje prej 18 pikë përqindje nga mesatarja 2016-2024 (51%). Për më tepër 27% janë shprehur se e kanë gjetur

punën e parë nga kategoria "tjetër", me një rritje prej 24 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (3%). Ndërkohë 20% e kanë gjetur përmes praktikës profesionale në biznes, me një rritje prej 1 pikë përqindje nga mesatarja 2016-2024 (19%) dhe 20% e kanë gjetur nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale, gazeta me një rritje prej 13 pikë përqindje nga mesatarja 2016-2024 (7%).

Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2016-2025)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë	13%	0%	14%	0%	0%	10%	5%	10%	12%	**20%**
Nga njohjet, lidhjet familjare, miqtë	88%	75%	43%	50%	70%	38%	26%	43%	28%	**33%**
Nga praktika profesionale në biznes	0%	25%	11%	25%	10%	24%	42%	14%	16%	**20%**
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim	0%	0%	7%	25%	15%	10%	5%	5%	4%	**0%**
Nga mësuesit	0%	0%	4%	0%	0%	0%	11%	10%	4%	**0%**
Nga qendra e karrierës/njësia e zhvillimit në shkollë	0%	0%	7%	0%	5%	14%	11%	19%	8%	**0%**
Tjetër	0%	0%	14%	0%	0%	5%	0%	0%	28%	**27%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=12); **2017** (N=4); **2018** (N=29); **2019** (N=8); **2020** (N=22); **2021** (N=25); **2022** (N=24); **2023** (N=21), **2024** (N=25), **2025** (N=15)

Lidhur me mënyrat e mbështetjes së shkollës në kapërcimin e fazës tranzitore drejt tregut të punës (shiko tabelën 8), në vitin 2025 43% e të diplomuarve kanë pohuar se shkolla i ka mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë, me një rritje prej 16 pikësh përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (27%). Për më tepër 32% kanë pohuar se shkolla i ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit, me një rënie prej 12 pikësh përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (44%) si dhe 11% kanë pohuar se shkolla i ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë, me rënie me 15 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (26%). Nga ana tjetër vihet re që 16% e të diplomuarve janë shprehur se shkolla përgjithësisht nuk i ka ndihmuar duke pasur një rritje me 8 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2016-2024 (8%).

Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2016-2025)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë	0%	20%	29%	30%	39%	25%	35%	41%	26%	**42%**
Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit	44%	60%	55%	30%	52%	42%	30%	50%	30%	**32%**
Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë	22%	20%	26%	20%	13%	29%	30%	23%	48%	**11%**
Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar	22%	0%	3%	20%	9%	4%	5%	5%	7%	**16%**

Tjetër	11%	0%	3%	0%	0%	8%	15%	5%	4%	**0%**


Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=9); **2017 (**N=5); **2018 (**N=31); **2019** (N=10); **2020** (N=23); **2021** (N=24); **2022** (N=20); **2023** (N=22), **2024** (N=25), **2025** (N=19)

Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme

Referuar figurës 21, numri i të diplomuarve që punojnë dhe studiojnë në të njëjtën kohë është 19% duke pasur një rënie me 35 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2016-2024 (54%).

Ndërkohë, numri i të diplomuarve që janë student/kursant për vitin 2025 është 51% duke shënuar një rritje me 38 pikë përqindje krahasuar me mesataren nga viti 2016-2024 (13%) e të diplomuar janë student/kursant në vit.


Figura 21: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=40); **2017 (**N=8); **2018 (**N=70); **2019** (N=22); **2020** (N=39); **2021** (N=38); **2022** (N=35); **2023** (N=30), **2024** (N=36), **2025** (N=37)

Të gjithë pra 100% të diplomuarit e gjurmuar që ndjekin kualifikime të mëtejshme kanë zgjedhur universitetin. Mesatarisht, 78% e të diplomuarve të gjurmuar përgjatë 2016-2025 ndjekin universitetin, 4% shkollë profesionale pas të mesmes dhe 17% kurse profesionale.


Figura 22: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=10); **2018 (**N=15); **2019** (N=4); **2020** (N=5); **2021** (N=5); **2022** (N=5); **2023** (N=3), **2024** (N=11), **2025** (N=7).

Në vitin 2025 71% e të diplomuarve që vijojnë studimet e mëtejshme universitare kanë përzgjedhur institucionet private ndërsa 29% institucionet publike. Mesatarisht, 65% e të diplomuarve 2020-2025 që ndjekin studime të mëtejshme kanë përzgjedhur institucionet publike dhe 35% institucionet private.


Figura 23: Lloji i institucionit (2020-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2020** (N=5); **2021** (N=5); **2022** (N=5); **2023** (N=3), **2024** (N=11), **2025** (N=7)

Ndërkohë, të pyetur nëse studimet që po ndjekin lidhen me shkollën që kanë bërë (shiko figurën 24), 57% e të gjurmuarve që studiojnë janë shprehur se fusha e studimeve që po ndjekin tani lidhet me shkollën që kanë bërë. Mesatarisht, 49% e të diplomuarve 2020-2025 kanë pohuar se fusha e studimeve lidhet me shkollën që kanë ndjekur përkundrejt 51% të cilët janë shprehur se studimet nuk lidhen me profesionin.

Figura 24: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2020** (N=5); **2021** (N=5); **2022** (N=5); **2023** (N=3). **2024** (N=12), **2025** (N=7)

Të pyetur mbi arsyet e ndjekjes së studimeve të mëtejshme (shiko tabelën 9), 57% e të diplomuarve në 2025 janë përgjigjur për të fituar një kualifikim më të lartë me një rënie prej 16 pikë përqindjeje prej mesatares së viteve 2026-2024 (41%) dhe 29% për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale me një rritje prej 15 pikë përqindje krahasuar me mesataren e të diplomuarve 2016-2024 (14%). Mesatarisht, 43% e të diplomuarve 2016-2025 që ndjekin kualifikime të mëtejshme japin si arsye kryesore fitimin e një kualifikimi më të lartë, 16% për të gjetur një punë më të mirë, 38% për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale dhe 2% pasi nuk po gjenin dot punë.

Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2025)

	2016	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Për të fituar një kualifikim më të lartë	60%	40%	0%	20%	40%	60%	67%	42%	**57%**
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	20%	27%	25%	0%	0%	0%	33%	8%	**29%**
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	10%	27%	75%	80%	60%	40%	0%	50%	**0%**
Nuk po gjeja dot punë	10%	7%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	**0%**

Tjetër	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	**15%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2016** (N=10), **2018** (N=15); **2019** (N=4); **2020** (N=5); **2021** (N=5); **2022** (N=5); **2023** (N=3), **2024** (N=11), **2025** (N=7)


Shënim: Mungojnë të dhënat për vitin 2017

Commented [IS1]: Ne databaze nuk jane, please check nese jane ne raportin e vitit te kaluar. If not do i kerkojme nga raportet e kaluara

Të diplomuarit pa punë

Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit për vitin 2024 është 27% duke shënuar një rritje krahasuar me 2 vitet e fundit. Mesatarisht, 28% e të diplomuarve përgjatë viteve 2016-2025 kanë qenë të papunë një vit pas diplomimit.


Figura 25: Papunësia ndër vite (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2016** (N=40); **2017** (N=8); **2018** (N=70); **2019** (N=22); **2020** (N=39); **2021** (N=38); **2022** (N=35); **2023** (N=30), **2024** (N=36), **2025** (N=37)

Të pyetur nëse po kërkonin punë, 70% e të diplomuarve të papunë për vitin 2025 pohuan që ishin në kërkim të një pune. Mesatarisht, 72% e të diplomuarve të papunë përgjatë viteve 2020-2025 janë në kërkim të një pune ndërsa 28% nuk janë në kërkim të një pune.

Figura 26: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2020** (N=11); **2021** (N=9); **2022** (N=9); **2023** (N=3), **2024** (N=3), **2025** (N=10).

67% e të diplomuarve të papunë për vitin 2025 janë shprehur se arsyeja kryesore e papunësisë (shiko tabelën 10), është se mungon eksperienca e punës. Në raport me vitet e kaluar kemi një rritje me 51 pikë përqindje në këtë kategori (mesatarja 2016-2024 (16%). Ndërkohë, 33% e të diplomuarve në 2025 u shprehen se nuk kanë njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur punë. Mesatarja e viteve 2016-2024 për këtë kategori është 13%. Në këtë aspekt, vërehet një rritje prej 120 pikë përqindje për vitin 2025.

Tabela 10: Arsyet kryesore të papunësisë (2016-2025)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Më mungon eksperienca e punës	21%	0%	9%	0%	25%	0%	25%	33%	33%	**67%**
Njohuritë që kam marrë nga shkolla nuk përputhen me tregun e punës	14%	0%	9%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	**0%**
Ofertat për punë nuk lidhen me arsimimin tim	21%	0%	32%	9%	0%	25%	75%	67%	33%	**0%**
Nuk kam njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur një punë	7%	67%	0%	9%	13%	25%	0%	0%	0%	**33%**
Nuk ka punë në qarkun tim	14%	0%	23%	9%	38%	25%	0%	0%	33%	**0%**
Jam i/e angazhuar në punë familjare	14%	33%	14%	18%	0%	0%	0%	0%	0%	**0%**


Nuk kam burime të mjaftueshme për t'u vetë-punësuar	0%	0%	0%	45%	0%	0%	0%	0%	0%	**0%**
Tjetër	7%	0%	0%	9%	25%	25%	0%	0%	0%	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2016** (N=14); **2017** (N=3); **2018** (N=22); **2019** (N=11); **2020** (N=8); **2021** (N=4); **2022** (N=4); **2023** (N=3), **2024** (N=3), **2025** (N=10)

Të pyetur rreth formave që përdorin për të kërkuar një vend pune (shiko figurën 27), 29% (2 nga 7)e të diplomuarve në 2025 janë përgjigjur nëpërmjet Zyrës së Punës, 43% (3 nga 7) e të diplomuarve në 2024 janë përgjigjur nëpërmjet njoftimeve për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë etj njohjeve, lidhjeve familjare, miqve dhe të njohur, 14% (1 nga 7) nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve dhe të njohurve, 14% (1 nga 7) duke kontaktuar drejtpërdrejtë me bizneset (duke dërguar CV etj) dhe 14% (1 nga 7) nëpërmjet shkollës. Vëreni, të gjurmuarit mund të zgjedhin më shumë se një alternativë për këtë pyetje.

Sikurse vihet re nga figura, gjetja e një vendi pune nëpërmjet njoftimeve për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë etj.


Figura 27: Metodat e kërkimit për punë (2020-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2020** (N=8); **2021** (N=4); **2022** (N=4); **2023** (N=3), **2024** (N=3), **2025** (N=7).

60 % e të diplomuarve të papunë në vitin 2025 ka qenë në marrëdhënie punë më parë. Mesatarisht 31% e të diplomuarve të papunë për periudhën 2016-2025 kanë qenë në marrëdhënie pune më parë. Sikurse e tregon edhe figura 28, viti 2025 shënon nivelin më të lartë i të diplomuarve të papunë që kishin qenë më herët në marrëdhënie pune dhe më i ulëti në vitin 2017 (0%).

Figura 28: Niveli i të diplomuarve të papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2016** (N=14); **2017** (N=3); **2018** (N=22); **2019** (N=11); **2020** (N=11); **2021** (N=9); **2022** (N=9); **2023** (N=3), **2024** (N=3), **2025** (N=10).

Propozimet për përmirësim në shkollë

Të pyetur se për çfarë aspektesh ka nevojë për përmirësim shkolla me qëllim përgatitjen më të mirë të nxënësve për tregun e punës, të gjurmuarit pohuan se të gjitha aspektet e shkollës të paraqitura në tabelën 12 kanë "shumë/jashtëzakonisht shumë" nevojë për përmirësim. Sipas rezultateve të të gjurmuarve në vitin 2025, theksi është vënë tek përmirësimi i praktikës në biznes me 87% me një rritje prej 26 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2016-2024 (61%), nevoja për përmirësim të këshillimit të karrierës 81% më një rritje prej 28 pikësh përqindje nga mesatarja 2016-2024 (53%), aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve (79%), me një rritje prej 27 pikë përqindje nga mesatarja (52%), bashkëpunimi me bizneset (78%) me një rritje prej 17 pikë përqindje nga mesatarja (61%) si dhe tek përmirësimi i praktikës në shkollë (77%) me një rritje prej 18 pikë përqindje nga mesatarja (59%).

Tabela 111: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkollë "shumë/jashtëzakonisht shumë"


	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Infrastruktura	44%	20%	19%	20%	31%	90%	60%	50%	62%	**68%**
Kurrikula			19%	20%	28%	67%	57%	59%	52%	**68%**
Tekstet dhe materialet	22%	20%	16%	40%	28%	70%	63%	57%	57%	**64%**
Metodat e mësimdhënies	56%	20%	16%	60%	26%	81%	60%	62%	58%	**72%**
Aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve			32%	30%	33%	83%	69%	62%	56%	**79%**
Praktika në shkollë	33%	60%	35%	40%	49%	81%	71%	67%	61%	**77%**
Praktika në biznes	11%	100%	39%	60%	51%	91%	71%	61%	65%	**87%**

Këshillimi i karrierës	11%	60%	45%	30%	41%	76%	69%	69%	71%	**81%**
Bashkëpunimi me bizneset	22%		42%	50%	49%	86%	74%	68%	70%	**78%**
Bashkëpunimi me zyrat e punësimit	33%	20%	16%	60%	49%	78%	69%	67%	70%	**76%**

Shënim: Kjo është pyetje ku janë marrë të dhënat e të diplomuarve që janë përgjigjur "shumë/jashtëzakonisht shumë". Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=9); **2017** (N=5); **2018** (N=31); **2019** (N=10); **2020** (N=39); **2021** (N=36); **2022** (N=35); **2023** (N=28), **2024** (N=27), **2025** (N=22)

Nëse do të kishin mundësi, 86% e të diplomuarve do të zgjidhnin të njëjtën degë dhe të njëjtën shkollë (shiko figurën 29). Mesatarisht, gjatë viteve 2018-2025, 91% e të diplomuarve do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë dhe të njëjtën degë.

Figura 29: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2018-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018** (N=69); **2019** (N=22); **2020** (N=39); **2021** (N=38); **2022** (N=35); **2023** (N=30), **2024** (N=36), **2024** (N=37)

Të disagreguara sipas drejtimeve, përzgjedhja e të njëjtës degë dhe shkollë paraqitet në tabelën 13. Për vitin 2025, 79% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore do të zgjidhnin të njëjtën degë dhe të njëjtën shkollë. Ndërkohë, 94% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm do të përzgjidhnin të njëjtën degë dhe të njëjtën shkollë.

Mesatarisht, nga viti 2018-2024, 92% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 96% e të diplomuarve në Shërbime Sociale Shëndetësore do të përzgjidhnin të njëjtën degë. Ndërkohë, 92% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 91% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë.


Tabela 122: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2025)

		Hoteleri-Turizëm	Shërbime Sociale dhe Shëndetësore
2018	Degë	97%	
	Shkollë	94%	
2019	Degë	100%	
	Shkollë	100%	
2020	Degë	94%	
	Shkollë	94%	
2021	Degë	97%	100%
	Shkollë	97%	75%
2022	Degë	76%	100%
	Shkollë	76%	100%
2023	Degë	86%	100%
	Shkollë	86%	100%
2024	Degë	95%	97%
	Shkollë	95%	95%
2025	Degë	**94%**	**79%**
	Shkollë	**94%**	**79%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2018**: N_{HT}=33; **Baza 2019**: N_{HT}=13; **Baza 2020**: N_{HT}=31; **Baza 2021**, N_{HT} =30, N_{SHSSH}=8; **Baza 2022:** N_{HT}=21, N_{SHSSH}=6; **Baza 2023:** N_{HT}=21, N_{SHSSH}=9, **Baza 2024:** N_{HT}=19, N_{SHSSH}=17, **Baza 2025:** N_{HT}=18, N_{SHSSH}=19.

Të ndara sipas gjinisë përzgjedhja e të njëjtës degë studimi dhe shkollë jepet në figurën 30. Sikundër e tregon edhe figura, 83% e të diplomuarave të gjinisë femërore do të përzgjidhnin të njëjtën degë dhe të njëjtën shkollë përkundrejt 89% të diplomuarve të gjinisë mashkullore të cilët do të përzgjidhnin të njëjtën degë dhe të njëjtën shkollë.

Figura 30: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi dhe shkollë sipas gjinisë 2025



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza M** (N=19); **Baza F** (N=18)

Planet për të ardhmen

Të pyetur për planet që kanë të diplomuarit për të ardhmen e tyre të afërt në aspektin profesional dhe të kualifikimit të mëtejshëm (shiko tabelën 14), 51% e të diplomuarve në vitin 2025 kanë pohuar se kanë dëshirë të kenë filluar biznesin e tyre. Aspiratat për sipërmarrje në këtë vit kanë shënuar rritje me 12 pikë përqindje në raport me mesataren e viteve 2016-2024 e cila ka qenë 39%.

Parë në një këndvështrim krahasues, në planet e tyre për të ardhmen, mesatarisht 23% e të diplomuarve shprehen se dëshirojnë të jenë të punësuar dhe 23% të gjejnë një punë të lidhur ngushtë me fushën e tyre të studimit (mesatarja dhjetë brezave). Ndërkohë, 19% (mesatarja e dhjetë brezave) shprehen se do ndjekin studime të mëtejshme dhe 16% se duan të emigrojnë jashtë vendit. Ndërkohë, dëshira për migrim të brendshëm është 0% për të nëntin vit radhazi.

Tabela 133: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2016-2025)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Të jem punësuar	25%	13%	58%	32%	26%	21%	14%	13%	17%	**14%**
Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit	3%	13%	13%	23%	23%	32%	31%	23%	25%	**43%**
Të kem filluar biznesin tim	12%	13%	9%	55%	59%	45%	40%	57%	58%	**51%**
Të kem ndjekur studime të mëtejshme	12%	38%	16%	9%	8%	13%	17%	23%	33%	**8%**
Të kem emigruar jashtë vendit	0%	63%	9%	23%	18%	8%	17%	3%	11%	**5%**
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	36%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	**0%**
Tjetër	36%	0%	10%	0%	3%	3%	3%	7%	0%	**11%**

Shënim: Kjo është pyetje me përgjigje të shumëfishta. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%.**Baza**: **2016** (N=24), **2017** (N=8), **2018** (N=69); **2019** (N=22); **2020** (N=39); **2021** (N=38); **2022** (N=35); **2023** (N=30), **2024** (N=36), **2025** (N=37)

Rekomandime për forcimin institucional

Rekomandimet e mëposhtme lidhen drejtpërdrejt me gjetjet e raportit të gjurmimit për shkollën "Kristo Isak". Për brezin 2025 janë gjurmuar 37 nga 41 të diplomuarit. Rezultatet sipas profileve dhe nëngrupeve duhen interpretuar me kujdes, ndërsa mospërputhjet në shifra dhe baza kërkojnë verifikim para përdorimit në planifikim.

1. Praktikë më e dobishme për përgatitjen për punë

Shkolla të diskutojë me të diplomuarit dhe mentorët se cilat aftësi dhe përvoja kanë munguar gjatë praktikës. Planet e praktikës në shkollë dhe biznes të rishikohen me detyra konkrete, objektiva të qarta dhe vlerësim të rregullt të përparimit.

Gjetja: Raporti paraqet praktikën në biznes si prioritetin kryesor për përmirësim, me 87%, dhe praktikën në shkollë me 77%. Gjithashtu, 79% kërkojnë përmirësimin e aftësive teorike dhe praktike të mësuesve. Baza dhe përqindjet e këtyre treguesve duhen verifikuar, pasi tabela shënon vetëm 22 përgjigje.

2. Orientim në karrierë me kontakte konkrete për punësim

Këshillimi për kërkimin dhe aplikimin për punë të shoqërohet me takime me punëdhënës, njoftime për vende të lira dhe ndjekje pas diplomimit. Të forcohet bashkëpunimi me zyrën e punësimit për të diplomuarit që kërkojnë punë.

Gjetja: Vetëm 11% raportojnë se shkolla i ka ndihmuar të vendosin kontakte me punëdhënës, nga 48% në 2024. Orientim mbi mundësitë e punësimit raportojnë 32%, ndërsa 16% thonë se shkolla përgjithësisht nuk i ka ndihmuar (N=19).

3. Mbështetje individuale për të diplomuarit pa punë

Shkolla të kontaktojë të diplomuarit pa punë për të kuptuar pengesat dhe për t'i orientuar drejt mundësive përkatëse. Të shqyrtohen veçanërisht vështirësitë e vajzave dhe arsyet e ndërprerjes së marrëdhënieve të mëparshme të punës.

Gjetja: Pa punë janë 10 nga 37 të diplomuarit, prej të cilëve 7 kërkojnë punë. Papunësia raportohet nga 6 prej 18 vajzave dhe 4 prej 19 djemve. Gjithashtu, 6 nga 10 të diplomuarit pa punë kanë qenë më parë në marrëdhënie pune, ndaj mbështetja duhet të përfshijë edhe rikthimin në punësim.

4. Të shqyrtohen rrugët e punësimit në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore

Njësia e Zhvillimit të diskutojë me të diplomuarit e këtij profili dhe punëdhënësit për mundësitë e punësimit, aftësitë e kërkuara dhe nevojat për kualifikim të mëtejshëm. Fillimisht të verifikohet treguesi i lidhjes së punës me arsimin.

Gjetja: Raporti paraqet vetëm 14% të punësuar në fushën e studimit në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, kundrejt 90% në Hoteleri-Turizëm. Megjithatë, bazat e shënuara për këta tregues nuk përputhen qartë me përqindjet dhe bazën e përgjithshme. Në profilin social dhe shëndetësor, 5 nga 19 të diplomuarit janë pa punë dhe 5 vijojnë studimet.

5. Mbështetje praktike për interesin për sipërmarrje

Të diplomuarve të interesuar për hapjen e një biznesi t'u ofrohet këshillim për zhvillimin e idesë, vlerësimin e tregut dhe përgatitjen e një plani të thjeshtë biznesi. Të krijohen kontakte me sipërmarrës dhe shërbime mbështetëse.

Gjetja: Në 2025, 51% e të diplomuarve dëshirojnë të kenë filluar biznesin e tyre brenda dy viteve të ardhshme, ndërsa 11% janë aktualisht të vetëpunësuar (N=37). Ky dallim kërkon sqarimin e nevojave dhe të gatishmërisë për ta konkretizuar interesin.